

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL NR.3  
Datë 25.02.2026 ora 14 : 00<sup>oo</sup>

Zhvillohet mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak, në sallën e mbledhjeve të Këshillit në katin e dytë pranë ish Bashkisë Rogozhinë.

**Rendi i ditës :**

Në mbështetje të shkresës “Njoftim”, të Zëvendëskryetarit të Këshillit Bashkiak me Nr.731.Prot datë 18.02.2026, me rend dite si më poshtë :

- 1- Miratim i rendit të ditës.
- 2- Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 03.02.2026.
- 3- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”.
- 4- Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i pushtetit vendor”.
- 5- Miratim i projekt - vendimit, “Për miratimin e Planit Vendor të veprimit për barazinë gjinore të bashkisë Rogozhinë për vitin 2026-2028”.
- 6- Njohje me planin operacional vjetor 2026-2027, “Për administrimin e pyjeve dhe të kullotave të Bashkisë Rogozhinë”.
- 7- Raport nga drejtoria e bujqësisë , mbi masat e marra për sistemin e kullimit dhe vaditjes dhe për gjendjen e rezervuareve në territorin e bashkisë Rogozhinë.
- 8- Raport, mbi veprimtarinë e Qendrës Kulturore “Haxhi Memolla” për vitin 2025 si dhe aktivitetet e parashikuara për vitin 2026.
- 9- Të ndryshme

**Marrin pjesë Këshilltarët prezentë në sallë :**

Erind Tosku, Shpati Kolgega, Enver Memolla, Alime Hoxha, Gezime Met-hasani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Saimir Cani, Dhurata Meka , Altin Tosku, Lorena Baku, Mitat Daja, Hekuran Xhani .

**Mungojnë :**

-1-



Besnike Coraj, Sokol Gosa, Fatmira Thartori, Mukades Gixhari, Renato Kalemi, Lulzim Hasa, Lije Dedej, Merilin Saraci .

**Të ftuar :**

1. Andi Proshka - Nënkyetar i Bashkisë ushtrues i detyrës së kryetarit.
2. Astrit Mertiri - Administratori i Njësisë Administrative Kryevidh.
3. Rezart Vogli - Drejtor i Financës.
4. Tomorr Thartori - Drejtor i Politikave Urbane.
5. Valmira Troka - Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse.
6. Ledian Hasani - Drejtor i mbrojtjes dhe kujdesit social.
7. Orges Tosku - Drejtor i Arsimit, Kulturës, Turizmit, Rinisë dhe Sporteve.
8. Marsida Thartori - Drejtore e të Ardhurave dhe Zhvillimit Ekonomik.
9. Enkela Ballabani - Drejtore e zyrës Juridike.
10. Elton Xhani - Drejtor i Bujqësisë, Veterinarisë, Pyjeve, Kullimit dhe Vaditjes.
11. Adriatik Lekaj - Përgjegjësi i zyrës së emergjencave civile.
12. Artur Kaja - Përgjegjës i sektorit të pyjeve.
13. Klea Dushku - Përgjegjëse e zyrës IT.

**Drejtton mbledhjen :**

Erind Tosku – Zëvendëskryetar i Këshillit.

Ndodhen në sallën e Këshillit Bashkiak : Këshilltarët e sipërcituar, si dhe specialistët e Bashkisë që janë thirrur për të shqyrtuar dhe relatuar pikat e rendit të ditës të sektorit që mbulon secili prej tyre, sipas axhendës ditore. Pasi konfirmohet kuorumi i nevojshëm, 13- Këshilltarë, z. Hekuran Xhani i bashkohet në vijim mbledhjes së këshillit.

**HAPET MBLEDHJA**

Përsëritje të nderuar Këshilltarë! Meqë kemi kuorumin e nevojshëm mbledhjen e deklaroj zyrtarisht të hapur!

-Marrin pjesë në mbledhje këshilltarët : Erind Tosku, Shpati Kolgega, Enver Memolla, Alime Hoxha, Gezime Met-hasani, Silvana Aliu, Indrit Dedej, Saimir Cani, Dhurata Meka , Altin Tosku, Lorena Baku, Mitat Daja .



-Lexojmë Vendimet me karakter individual që u morën në mbledhjen e këshillit të datës 03.02.2026 të cilat hyjnë në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore“, i ndryshuar , si më poshtë :

Vendim nr . 10 . Për miratimin e listës së familjeve që do të përfitojnë nga programi për “Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara”.

Vendim nr . 12 . Për miratimin e Komisionit të përkohshëm për verifikimin e procesit të rindërtimit për banesat e dëmtuara nga tërmeti i datës 26 Nëntor 2019 me nivel dëmi DS4, DS5 në Bashkinë Rrogozhinë.

Gjithashtu lexojmë dhe verifikimin ligjor të ardhur nga Prefekti i Qarkut për :

Vendimin nr . 11 . datë 03.02.2026 Për miratimin në parim të deklaratës për bashkëfinancim të familjeve që do të përfitojnë nga programi për “Përmirësimin e banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara për vitin 2026”.

Konfirmohet në parim referuar ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, si dhe shkresën nr.628/2. prot datë 23.01.2026 “Mbi fondet për programet e strehimit për vitin 2026”, të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit.

Para se të kalojmë në rendin e ditës po ju lexoj një shkresë që na ka ardhur për dijeni nga Prefekti i Qarkut Tiranë, pasi kemi njoftuar Prefektin për mbarimin përpara afatit të mandatit të kryetarit të bashkisë.

Gjithashtu ju bëj me dije që sot dot të shqyrtohet dhe problematika e rrugës që lidh fshatin Domen dhe Kavajën në vendin e quajtur “Rrëpira e keqe”, pikë kjo e cila u përfshi dje në rendin e ditës.


Tjetër kemi dhe projektvendimin që jua përcolla dje në ẽhatsapp “Për pranimin e të moshuarës znj. Drita Shira në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar ‘Missionaries of Charity’ (motrat e Nënë Terezës’ Tiranë”. Jeni dakord ta përfshijmë në rend dite këtë projektvendim? Pro, kundër, abstenim.

Të gjithë pro?

Miratohet

*-Miratohet me 12-vota pro, përfshirja në rendin e ditës e projektvendimit, “Për pranimin e të moshuarës znj. Drita Shira në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar ‘Missionaries of Charity’ (motrat e Nënë Terezës’ Tiranë”).*

Gjithashtu kam një kërkesë nga drejtori i shërbimeve zoti Ledian Hasani që pikën e zonjës Drita Shira ta kalojmë në vazhdimësi të rendit të ditës?



**Mitat Daja** . Vetëm të parën?

**Erind Tosku** . Po tek pika katër pas ndihmave ekonomike, ti kalojmë.

**Erind Tosku**. Vijojmë me rendin e ditës. Jeni dakord me rendin e ditës? E hedhim në votim: pro, kundër, abstenim. Të gjithë pro. Në rregull.

**Mitat Daja** . Jemi pajisur me letra për dijeni që i është vënë prefektit përse i përket mbarimit të mandatit kryetarit të bashkisë, dhe supozohet që është bërë edhe një kërkesë për mbledhje që nuk u realizua. Një ndër pikat e saj ishte edhe konstatimi i mbarimi i mandatit , këshilli nuk u mbledh si u lajmërua prefekti zyrtarisht, kush e mori tagrin në emër të këshillit të dërgojë shkresë prefektit dhe a është ligjore kjo gjë?

**Silvana Aliu** . Edhe unë jam dakort me atë që thotë Mitati thjesht dua të di si po procedohet sepse duhet të ishte njoftuar këshilli i ministrave.

**Erind Tosku** . E njofton prefekti këshillin e ministrave jo ne, ne delegojme tek prefekti.

**Mitat Daja** . Kush e mori tagrin e këshillit bashkiak në këtë rast?

**Alime Hoxha** . Ervis mund të ja shpjegosh pak të lutem procedurën e ndjekjes?

**Silvana Aliu** . Nuk po ja kërkojmë Ervisit por Erindit sepse në letër ishte emri i tij.

**Erind Tosku** . Po po, ne nuk i bëjmë gjërat pa dijeni. Duke qenë se në mbledhjen e rradhës fatkeqësisht kryetari mori dënim normalisht bashkia ishte pa kryetar dhe si procedurë kalohet në dijeni prefekti i qarkut që bashkia jonë nuk ka kryetar. Automatikisht nënkryetari që është kalon në detyrë. Këshillin e ministrave nuk e njofton këshilli bashkiak i Rrogozhinës por e njofton prefekti. Letra që ka ardhur nga prefekti që është njoftuar këshilli i ministrave tregon që ligjërisht jemi në rregull si këshill bashkiak. Në rendin e ditës ishte njohja e këshillit bashkiak me nënkryetarin që do të mari detyrën.

**Indrit Dedej** . Ti ke shkruar që e ka njoftuar këshilli bashkiak?

**Erind Tosku** . Në rregull, ne vëmë në dijeni prefektin...

**Indrit Dedej** . E vë këshilli jo ti, ti një votë ke. Me kë e ke bërë mbledhjen ti?

**Erind Tosku** . Nuk e hodhëm në votim. Kjo procedurë nuk bëhet me votim, për kryetarin dhe nënkryetarin nuk hidhet votim.

**Indrit Dedej** . Kë lajmërove?



**Erind Tosku** . Të gjithë, e ke njoftimin. Nuk kishe dëshirë ti Indrit që të vije dhe njiheshe me kryetarin, ti nuk erdhe dhe ne nuk mund ta lëmë bashkinë pa kryetar dhe pa drejtim dhe prefekti u njoh me z. Andi Proshka si nënkryetar...

**Mitat Daja** . Të bëj një pyetje? Kryetari i bashkisë sot është kryetar i shkarkuar apo në detyrë?

**Alime Hoxha** . Duke qenë se ne kemi dhe juristen e bashkisë sot këtu mund të na e shpjegojë të gjithë procedurën edhe për kryetarin edhe për prefektin?

**Silvana Aliu** . Ne nuk e duam nga zyra juridike por nga ty.

**Erind Tosku** . Ta shpjegova, nqs informacioni im nuk është i qartë... ju nuk erdhët po e shpjegoj.

**Silvana Aliu** . Ne po kërkojmë që me shpejtësi brenda ditës...

**Erind Tosku** . Nuk kam tagrin të flas në emër të këshillit të ministrave...

**Silvana Aliu** . Ti ke tagrin të flasës në emër të këshillit?

**Erind Tosku** . Po ti nuk erdhe..

**Silvana Aliu** . Po as ti se bërë mbledhjen..

**Erind Tosku** . Si nuk e bëra? E lexuar rendin e ditës ju, nuk kishte as votim.


**Enver Memolla** . Përsa i përket kësaj çështje duke qenë se dhe bashkë kemi qenë anëtar të vjetër, ka ndodhur që ka humbur jetën ish kryetari i mëparshëm njsë pastë dhe sipas ligjit kur ka dy nënkryetarë këshilli mblidhet dhe përzgjidhet një kryetar zgjedhjeve. Përsa i përket pyetjes së zotit Mitat nuk është këshilli bashkiak që e bën vakancën. Këshilli bashkiak vë në dijeni prefekturën.

**Mitat Daja** . Këtë po them dhe unë.

**Enver Memolla** . Prefekti vë në dijeni këshillin e ministrave, që do të thotë vënien e kryetarin e cakton mbledhja e këshillit të Ministrave, në moment këshilli përcakton nënkryetarin aktual dhe automatikisht shpall dhe vakancën në presidencë dhe brenda jo më pak se 30 ditësh dhe jo më shumë se 45 ditësh presidenti dekreton datën e zgjedhjeve. Aktualisht këshilli ministrave nuk është mbledhur akoma për Rrogozhinën..

**Indrit Dedej** . C punë kemi me këshillin e ministrave ,ne kemi punë me këshillin bashkiak, nuk është zhvilluar mbledhje...

**Erind Tosku** . Ju po i ngatërroi gjërat, ja kishe ardhur ti atë ditë që nuk erdhe cfarë do të bëje ndryshe? Nuk ishte në vendim



**Indrit Dedej** . Ti vendose nënkryetarin pa u mbledh këshilli bashkiak...

**Erind Tosku** .Nuk ke vendimarrje kalon automatikisht.

**Indrit Dedej** . Unë flas në emër të grupit.

**Erind Tosku** . E kuptoni dhe e interpretoni sipas interesit këtë gjë, kalojmë tek rendi i ditës se nuk po arrini gjë me këtë pjesë sepse edhe tek ndihmat ekonomike po zoti Andi Proshka do firmosi që ti kalojmë familjeve ndihmat ekonomike. Me këtë pjesë ju po pengoni ndihmat ekonomike dhe nuk arrini gjë.

**Indrit Dedej** . Po pse ndalesh tek ndihmat ekonomike?

**Erind Tosku** . Sepse atë pikë kemi tek rendi i ditës..

**Silvana Aliu** . Nga mënyra se si po flet ne dhe ndihmat ekonomike do ti lëmë ti firmosi Andi por është respekti i banorë që ne kemi ardhur këtu. Ne ikim dhe i lëmë edhe ndihmat ekonomike.

**Erind Tosku** . Ajo është zgjedhja juaj, që sdoni ti kaloni ndihmat ekonomike qytetarëve.

**Silvana Aliu** .Kjo punë ka dashur me kohë, shqyrr që kemi ardhur ne që i kemi firmosur ndihmat ekonomike qytetarëve, qytetarët janë djegur e përmytur vinke sot ti për 50 mij që po u jep ti atyre..

**Erind Tosku** . Nuk po ja jap unë.

**Alime Hoxha** . Jemi për të diskutuar në këtë mbledhje sipas rendit të ditës apo cfarë ka ndodhur.

**Indrit Dedej** . Ne duam të flasim për gjërat që duam të dimë...

**Alime Hoxha** . Për cilat gjëra?

**Indrit Dedej** . Kush është ai që flet në emër të këshillit... vinka këtu ai e flet në emër të gjithë këshillit

**Alime Hoxha** . Indrit të lutem, e ke lexuar ligjin cfarë thotë?

**Indrit Dedej** . Ligji thot mblidhet këshilli bashkiak.

**Alime Hoxha** . Nuk thotë mblidhet, Erindi është në detyrën sot kryetar këshilli dhe e ka ai detyrën për ta njoftuar prefektin për këtë vakancë dhe na përfaqëson ne.

**Indrit Dedej** . Ne jemi kundra.

**Alime Hoxha** . Po për cfarë jeni kundra?

**Indrit Dedej** . Si e mblodhi ai këshillin bashkiak!!



**Silvana Aliu** . Je e vetëdijshme që më shumë kemi ardhur ne për asistencat sesa ka ardhur zotëria..

**Erind Tosku** . Clidhje ka kjo me rendin e ditës?

**Silvana Aliu** . Me asistencat që mbron qytetarët.

**Erind Tosku** . Jo i mbron ti.

**Silvana Aliu** . Unë kam qenë gjithmonë në mbledhje.

**Erind Tosku** . Nuk po arrin gjë me këto diskutime që në fillim të mbledhjes.

**Alime Hoxha** . Është detyra e Erindit të vë në dijeni për vakancën e krijuar dhe ai vetëm detyrën ka bërë asgjë tjetër.

**Erind Tosku**. Jo do e lëmë pa kryetar se dëshiron Silvana.

**Silvana Aliu** . Epo e con detyrën deri në fund sepse keni patur shpejtësinë që brenda ditës të bëni kërkesën, kthim përgjigje i keni patur të gjitha mundësi.

**Alime Hoxha** . Është bërë sipas afateve cdo gjë.

**Indrit Dedej** . Vazhdoni pra, vazhdoni. Unë jam kundër cdo vendimi..

**Erind Tosku** .Po rendi i ditës.

**Indrit Dedej** . Jam kundra cdo vendimi përvec qytetarëve.

**Erind Tosku** . Si të doni. Kalojmë tek rendi i ditës, kalim i procesverbalit Nr 2.

**Indrit Dedej**. Unë fus vetëm pikën e qytetarëve.


**Erind Tosku** . Unë do të kaloj me rendin e ditës ju e keni në dorë tuaj me votë. Miratim i procesverbalit Nr.2, të mbledhjes së Këshillit Bashkiak datë 03.02.2026. E hedhim në votim, pro, kundër, abstenim?

*-Nuk miratohet pika 2 (dy) e rendit të ditës.*

**Erind Tosku** . Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Janar 2025 nga fondi i Bllok - Ndihmës 6%”. Referon Drejtori i Mbrojtjes dhe kujdesit Social zoti Ledian Hasani.

-Pas relatimit të drejtorit.

**Erind Tosku** . E Hedhim në votim pikën 3 të rendit të ditës. Pro, kundër, abstenim.



*-Nuk miratohet me 7 (shtatë ) -vota pro, 5 (pesë)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim, pika 3 (tre) e rendit të ditës.*

**Erind Tosku** .Miratim i projekt - vendimit, “Për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet në nevojë për muajin Shkurt 2026 nga fondi i pushtetit vendor”. Referon Drejtori i Mbrojtjes dhe kujdesit Social zoti Ledian Hasani.

-Pas relatimit të drejtorit.

*-Nuk miratohet me 7 (shtatë ) -vota pro, 5 (pesë)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim, pika 4(katër) e rendit të ditës.*

**Erind Tosku** . Projektvendimi “Për pranimin e të moshuarës znj. Drita Shira në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar ‘Missionaries of Charity’ (motrat e Nënë Terezës’ Tiranë”. E Hedhim në votim pro, kundër, abstenim?

**Erind Tosku** . Të gjithë pro , miratohet

*-Miratohet me 12 (dymbëdhjetë ), -vota pro, 0 (zero)-vota kundër, 0 (zero) -vota abstenim,*

**Vendim nr .13.** Miratohet me 12 vota pro, projektvendimi i propozuar nga kryetari i bashkisë me Nr. 817 Prot datë 24.02.2026 “Për pranimin e të moshuarës znj. Drita Shira në qendrën e përkujdesit rezidencial për të moshuar ‘Missionaries of Charity’ (motrat e Nënë Terezës’ Tiranë” ,si dhe relacionin shpjegues i këtij projekt vendimi me nr. 817/1 . Prot datë 24.02.2026 .

**Erind Tosku** . Vazhdojmë me problematikën që lidh fshatin Domen dhe Kavajën në vendin e quajtur “Rrëpira e keqe” Referon z.Adriatik Lekaj

**Alime Hoxha** . Ky njoftim na ka ardhur te grupi nga Shpati, por ty thuhet që drejtohet në këshill bashkiak, a ka ardhur ne këshill bashkiak kërkesa?

**Ervis Shera** . Jo nuk ka ardhur zyrtarisht, por është paraqitur me anë të anëtarit të këshillit Shpati Kolgega

**Adriatik Lekaj** . Në bazë të kërkesës së qytetarëve drejtuar bashkisë Rrogozhinë, zyra e emergjencës civile ngrejti grupin e punës për konstatimin e rastit në fjalë duke vajtur në vendin e kërkuar dhe konstatoi që gjatë shirave të fundit dhe gjatë gjithë kohës, kjo rrugë ka shfaqur



probleme dëmtimi në të dyja krahët e saj sa që ka arritur në pikën më të ngushtë të kalimit 2.6 m ka lartësi 10m është rrugë ekzistuese, qindrvajecare e pamirëmbajtur e pa investuar. Për rastin në fjalë në ditën që morëm njoftimin pas verifikimit u njoftua titullari i bashkisë Rrogozhinë, prefektura Tiranë dhe drejtorja e përgjithshme e emergjencës civile. Sot kanë qenë në vendngjarje vetë përfaqësues të prefekturës nga Tirana. Rruga është në dalje të fshatit Dome që lidh fshatin me rrugën e Kavajës paraqet rrezik dhe kam ndërnarë të gjitha hapat e duhur për të njoftuar prefekturën dhe emergjencat civile. Para 3 muajsh është kërkuar të ndërhyhet sepse ne si emergjencë nuk e bëjmë dot sepse ajo rrugë kërkon shumë material mbushës dhe sërish nuk garanton qëndrueshmëri. Zgjidhja e vetme që do të mbetet gjithmonë është ndërtimi i një ure në atë pjesë rruge. Emergjencia dhe bashkia jonë mendoj unë pa qenë edhe kryetari nuk disponon fonde të tilla, don minimalisht 100 milion lekë të vjetra investim për ti dhënë zgjidhje. Kam dhe foto që ka shembje në të dyja anët e saj që ka filluar shembja dhe mbushja me dhe nuk do të ishte zgjidhje.

**Silvana Aliu** .Sa ka kjo problematikë në këto rrugë?

**Adriatik Lekaj** . Ka që nga shirat e fundit.

**Silvana Aliu** . Unë di që kjo problematikë ka 3 vite që është shqetësuese. Bashkisë i duhet që të shkonte gjëndj deri këtu që të ndërhynte?

**Adriatik Lekaj** . Për atë nuk jap përgjigje, unë di që emergjenca civile ka bërë konstatimin , proceverbalin dhe ka bërë njoftimin prefekturës, emergjencës së përgjithshme civile dhe bashkinë. Kjo është punë që ne bëjmë si emergjencë civile të ndërhyhet e të meren masa për të parandaluar aksidentet e mundshme.


**Shpati Kolgega** . Në kushtet që është ajo, nga ju rekomandohet të përdoret apo të mos përdoret? Që të marrim një masë.

**Adriatik Lekaj** . Atëherë, unë për procesverbalin që kam dërguar kryetarit dhe prefekturës kam bërë matje

**Shpati Kolgega** . Mendoj që ajo nuk mund të përdoret, duhet të bllokohet si rrugë, sepse është e lartë.

**Adriatik Lekaj** . Jo, unë kam bërë matje në atë rrugë dhe mua më del 2.6 m gjerësi. Mjetet e vogla maksimumi kanë 2.4 m, mund të kalojnë me kujdes. Por nuk rekomandohet për mjetet e rënda. Pra, për procesverbalin që kam bërë unë, kam bërë matje të kësaj rruge, edhe gjatësinë edhe gjerësinë.

**Mitat Daja** . Po sa është?



**Adriatik Lekaj** . Pse u bë problem dhe edhe në prefekturë, sot?

**Mitat Daja**. Sa është mundësia nga emergjenca civile për të bërë ndërhyrje emergjente? Deri ku shkon emergjenca civile e bashkisë?

**Administratori** . Unë jam administratori atje: nuk bëhet në mënyrë absolute.

Nuk bëhet ajo mbi 2 milion euro që bëhet.

**Silvana Aliu** . Edhe 3 apo katër atje janë banorë që jetojnë.

**Adriatik Lekaj** .Ajo rrugë, o Silvana, unë e kam të gjithën: sot është gjithë gropa.

**Silvana Aliu**. Jemi në 2026 nuk mund të thuash ti që ajo ka... që ka ç'të bëhet.

**Mitat Daja** . Pyetja ishte e tillë. Jam dakord që duhet bërë rruga ashtu si duhet, sepse janë njerëz dhe ata.Dakord, pyetja është për emergjencë. Pyetja i drejtohet Drejtorisë së Emergjencave: sa është mundësia për të investuar si emergjencë, sepse na ngelin njerëzit në rrugë?

**Astrit Mertiri** . Atëherë, jemi këtu. Jo më larg se sot dhe dje: edhe dje, edhe sot, ne kemi qenë në terren. Vetë unë kam qenë atje bashkë me kryetarin në detyrë, me nënprefektin e Tiranës dhe me dy specialistë të tjerë. Kemi qenë dhe e kemi parë. Unë jam rritur aty; nuk është puna se nuk e njihja si rrugë. E dija, por ajo ka degraduar në një farë mënyre. Aty është një tip “zalli” që rrëshket. Po nuk u bë me pilota, ajo nuk ka zgjidhje. Ky është mendimi im.

**Erind Tosku** . Zoti Astrit j'i japim fjalën qytetarit.

**Indrit Dedej** . Jo, t'i bëj pyetje administratorit. Ti, faleminderit që ke ardhur. Sa kohë ke që je administrator?

**Astrit Mertiri** . Kam një vit.

**Indrit Dedej** . Sa kohë e ke ngritur këtë problem?

**Astrit Mertiri** . Po s'ka rëndësi. E kam prekur, e kam. Atëherë po të them: para tre muajsh, tre-katër muajsh, kanë ardhur Fondi i Zhvillimit, kanë ardhur për të marrë një... dhe unë i kam kërkuar për ta bërë atë rrugë. I kam kërkuar rruga të niset nga Stërbegu, të bëhet lidhja deri në fund.

**Astrit Mertiri** . Një minutë. A më pyet?

**Indrit Dedej** . Po s'bëri punë fondi i zhvillimit, o shoku. Po të ishe për fondin e zhvillimit, e kishe mbaruar ti. Pse s'e mbarove zgjedhjen me Fondin e Zhvillimit ti?



**Astrit Mertiri** .Po them, a po më pyet?

**Silvana Aliu** .Nga banorët, para tre vjetëve, ka qenë e njëjta problematikë. Pse nuk u zgjidh pse nuk u morën masa?

**Astrit Mertiri** . Ka qenë para 30 vjetësh ky problem.

**Indrit Dedej** . Më fal, të bëj pyetje.

**Erind Tosku** . Në qoftë se ke pyetje, mbaroje pyetjen.

**Indrit Dedej** . E kam konkrete, pse ti, si administrator, a je në dijeni apo nuk je në dijeni për këtë?

*(I bashkohet mbledhjes z Hekuran Xhani në minutën 29 42)*

**Astrit Mertiri** . Cfarë pyetje është kjo je apo jo në dijeni?

**Indrit Dedej** .Jo për rrugën, o vëlla, po të them çfarë do them: është bërë një investim te një rezervuar (që s'ka rezervuar aty). E ke ngritur ndonjëherë problematikën që atje po bëhet një investim kot dhe s'është bërë investim te rruga?Asnjëherë.

**Silvana Aliu** .Prit se kam...

**Indrit Dedej** . Kështu që unë nuk kam pse të besoj ty, se s'ke... Ne të kemi kërkuar një milion herë të vijë administratori, asnjëherë s'keni ardhur. Kështu që pse t'ju besoj unë ty sot? Qytetari mund ta besojë, të shprehë çfarë kërkesë ka dhe sa mundësi ka që t'i bëhet zgjidhje qytetarit.

**Adriatik Lekaj** . Kjo rrugë del në Kavajë nuk ka rrugëaty është rrugë e keqe.


**Indrit Dedej** .Fondi i Zhvillimit nuk e zgjidhim ne. Ne, në qoftë se kemi projekt, e kalojmë projektin dhe e çojmë te Fondi i Zhvillimit.Në qoftë se ka projekt, ne e kalojmë projektin dhe e çojmë atje .

**Silvana Aliu** .Atëherë, rezervuari i Domjes ç'lidhje ka me këtë dua të dal diku tjetër? Ne erdhët këtu për një investim për rezervuar apo jo? Sepse nuk ka rrugë. Pse mendohet kaq shumë për rezervuar, kur s'ka rrugë? Pse nuk u bë rruga njëherë, pastaj të shkosh...

**Astrit Mertiri** . Rezervuari është në "Kazie" quhet Domje, rruga niset nga Stërbegu, kalon në Spanesh.

**Silvana Aliu** . E kupton ti ku e kam unë? Se s'janë fare se ku kalon rruga.Pse s'më morën si fillim rrugën? Rruga ka qenë bosh.

**Astrit Mertiri** .E di si është ai rezervuari?



**Indrit Dedej** . Ai nuk është fare rezervuar.

**Erind Tosku** . Po, zoti Enver

**Enver Memolla** . Kryetar, do kërkoj pak edhe nga kolegët që të jemi korrektë te kjo pjesë pa shkuar në debat . Çfarë është bërë është bërë, për të ardhmen banorët janë këtu..

**Indrit Dedej** .Unë dua të dëgjojmë qytetarët çfarë duan dhe sa mundësi kemi. Pse jo?

**Enver Memolla** .Unë dua një pyetje.

**Indrit Dedej** . Shefin e financës e kemi këtu?

**Enver Memolla** . Ka rrugë alternative përmes rrugëve për të shkuar në këtë fshat?

**Qytetari** . Nuk ka rrugë fare. Është e vetmja. Në qoftë se na e bllokojnë atë, duhet të kalojmë në Itali që të ikim. Kemi edhe një rrugë tjetër që të çon deri te rruga që janë tokat tona, jo më pak se 60 hektarë, në “Morra e Idris”, si i thoni... kjo është pjesa jonë. Nuk kemi rrugë nga të shkojmë, veç asaj. Kemi lënë një rrugë... domethënë, për fat, unë jam ish-pronar i vjetër dhe e kemi lënë për rrugë, por po dal unë për këtë: do kthehet prona, do vijë te unë, dhe familja nuk është dakord. Unë jam dakord të bëhet rruga jonë që të lidhet Spille me Domën. Se nuk ka fare rrugë po u mbyll ajo do të prenotojmë helikopter.

**Shpati Kolgega** . Ska rrugë alternative që të lidh me plazhin poshtë?

**Qytetari** . S’kemi rrugë fare sot. Nga tre rrugët, shiu na i ka prishur të treja. Nuk kemi rrugë me dalë në bregdet.

**Shpati Kolgega** . Më fal, një moment a ka një rrugë alternative që rregullohet më kollaj se kjo?

**Qytetari** . Më kollaj se kjo, për ne në Kavajë nuk ka. Ndërsa na quhemi bashki e Rrogozhinës...

**Adriatik Lekaj** . Ka qenë një rrugë në parcelën nr. 173, fraksion 19, me gjerësi 13 m në lindje dhe 4 m në perëndim. Kjo rrugë është e bllokuar se nga se nuk e di.

**Silvana Aliu** . Ai ddon rrugë të kalojë...

**Adriatik Lekaj** .Unë do shkoj në Kavajë që të shkoj tek ai..

**Silvana Aliu** .Ore, jemi gabim.

**Adriatik Lekaj** . Je gabim ti jo unë. Unë dal te lidhja me bashkinë tonë, njëherë nuk mos bëhet ajo. Po do bëhet lidhje nga bashkia jonë. Unë, që të shkoja atje duhet të shkoj në Kavajë.

**Silvana Aliu** . Ka kaluar ambulanca, ka kaluar me vështirësi.

**Adriatik Lekaj** . Po dakord, dakord. Unë dua rrugën e Stërbekut, të më shkojë nga Stërbegu deri në Domë, kjo fare. Unë nuk dua një pjesë rruge.



**Qytetari .** Një sekondë, kjo rrugë që do ti i intereson hajdutin!

**Adriatik Lekaj .** Unë dua rrugën Stërbek–Domë. Kjo është rruga e bashkisë tonë. të mos ta filloj nga fundi , ta fillojmë nga koka. Nga fundi është tjetër interes.

**Silvana Aliu .** Meqë mua s'më intereson Tirana, i bie që të bllokoj rrugën e Tiranës unë, se s'më intereson?

**Adriatik Lekaj .** Silvana ti thua kështu, të prishësh urën e Sinaballjes . Bëj urë, dalin në Cermë të hy në Rrogozhinë . Atëherë, ju kërkoni nga fundi te koka.

**Qytetari .** Ne duam... s'ka rrugë, s'ka rrugë.

**Adriatik Lekaj .** Nuk ka rrugë as Kazia nuk ka rrugë, as Paneshi...

**Erind Tosku .** Një sekondë tani, ju lutem. A ka mundësi t'i dëgjojmë deri në fund qytetarët, të flasim qytetarët, pastaj të diskutojmë dhe të gjejmë zgjidhjen më të mirë të mundshme? Tani, në qoftë se ne kemi mundësi si bashki, në qoftë se japim zgjidhje, do japim zgjidhje. Tani të dëgjojmë qytetarët: problematika, mundësitë...

**Enver Memolla .** Tani unë thashë që çështja është e ndjeshme, hall pa hall sepse halli është më i madh sesa qefi. Po tani unë e pyeta për rrugë alternative. Një sekondë, pyetja që bëra për rrugë alternative është që me fondet e bashkisë a ka mundësi të ndërhyjmë apo jo? Se këtu ishte ideja e pyetjes time. Se pastaj, që është e vetmja, e mora vesh edhe nga administratori edhe nga të tjerët. Është problem i madh, që nuk përballohet nga bashkia.

**Indrit Dedej .**Nuk duan asfalt ato.

**Qytetari .** Përgjigjja e tij është edhe për këtë drejtorin që është këtu para meje, thotë “zgjidhje të pjesshme”.

**Adriatik Lekaj .** Ju kërkoni zgjidhje të pjesshme, unë nuk dua zgjidhje të pjesshme. Unë dua, meqë këshilli është mbledhur, që t'ju ndihmoj juve: kërkesa do të jetë thelbësore. Kërkohej një rrugë brenda standardeve, quhet rrugë panoramike, nga Stërbegu në Domë. Bëhet rrugë.

**Qytetari .** Ne nuk po na ndihmon ky Fondi i Zhvillimit ta bëjë gjithë rrugën.

**Hekuran Xhani .** Kam një pyetje unë. Ky fshat nuk ka rënë nga dielli, ky fshat ka pasur një rrugë ekzistuese.

**Adriatik Lekaj .** Po.

**Hekuran Xhani .** Tani, rruga ekzistuese është prishur apo jo?

**Adriatik Lekaj .** Është ngushtuar nga rrëshqitjet, është bërë shumë e ngushtë.



**Hekuran Xhani** . Shumë bukur. Bashkia tani duhet t'u vijë në ndihmë qytetarëve për të rikonstruktuar rrugën.

**Adriatik Lekaj** . Po.

**Hekuran Xhani** . Ne kemi rregulluar një buxhet dhe kemi hedhur 800 milionë lekë , të hiqen 200 milionë dhe t'i bëhet rruga këtyre, sepse është emergjencë. Këto nuk kanë rrugë për të shkuar në spital. Në Rrogozhinë mund të bëhen ndoshta disa gjëra vetëm për zbulurim të qytetit, por këtu shkon në ndihmë urgjente. Shefi i financës është këtu. Është shumë e qartë: ne kemi buxhetin tonë, 800 milionë lekë për të investuar në bashki. Heqim 200 nga kjo shifër, sepse gjithë investimi i buxhetit është shumë në qytet, në Rrogozhinë. Unë kërkova njëherë 500 m atje te varrezat se nuk shkohej në baltë, dhe thamë ta bëjmë ne. Pse të presim Fondin e Zhvillimit? Atëherë këshilli është këtu, qeveria është këtu, t'i vijë në ndihmë, sepse këto kanë emergjencë... Do jetë turp, turp, me vdek atje, me vdek rrugës.

**Qytetari** . Atje ska rrugë me asfalt, atje s'ka asfalt.

**Hekuran Xhani** . Dëgjo, dëgjo a ju intereson ju rruga që ka qenë të rikonstruktohet, apo doni rrugë të re? Bëni kërkesën e qartë. Ne jemi të zgjedhurit tuaj dhe jemi në mbështetje tuajën.

**Qytetari** . Një sekondë, kërkesa më minimale ne po kërkojmë të kalojmë. Unë e dua rrugën mundësisht ta bësh me trotuar, ma bëj asfalt, ma bëj të jetë e mbyllur, mos të lagem nga shiu. Jo, more thjesht duam të kalojmë , të kalojmë atje, të kalojmë edhe poshtë në Spille ku kam arën, se kam bereqetin.

**Hekuran Xhani** . Edhe njëherë po ta drejtohem shqip, ju kërkoni të rikonstruktohet rruga që është prishur. Jeni dakord ju me mua?

**Qytetari** . Ja të jua tregoj, këtu, këtu... këtu kemi hedhur ca gurë. Këtu mund të isha unë dhe gruaja ime viktimë, se kemi hedhur ca gurë dhe këtu na ka... kjo është pjesa. Domethënë që nuk kalon makina më. Ajo thotë 2.6 m, mund të jetë 2.4, mund të jetë 2.8. Atëherë, me 2.6 kalojmë.

**Adriatik Lekaj** . Makina e madhe nuk futet. Makina e vogël, me shumë kujdes.

**Adriatik Lekaj** . Atëherë, toka që është atje nuk bën mbushje, do urë zgjidhje përfundimtare. Atëherë bëhet urë. Me Fondin e Zhvillimit ta bësh gjithë rrugën, rrugë 100 m...

**Enver Memolla** . Po tani, gjëja e parë duket që investimi është i madh dhe bashkia nuk i ka fondet. E dyta, ndërhyrjet që mund të bëjë bashkia...

**Erind Tosku** . Ne po bëjmë pyetje që të japim zgjidhje.

**Qytetari** . Ju jeni të zgjedhurit tonë, ju duhet ta keni shkelur këtë fshat, se përse jeni zgjedhur? Dikush e ka shkelur... Ne nuk po kërkojmë... po kërkojmë cila është rruga e kalueshme drejt, që ne mos të presim viktimën.



**Erind Tosku** . Flasim me radhë tani. Po bëjmë edhe më shumë zhurmë.

**Enver Memolla** . Është çështje që prek. Duket që sipas bashkisë nuk ka fonde. Si këshill mund ta vëmë dot në emergjencë?

**Mitat Daja** . Po thotë 10 metra lartësi, o vëlla, o shoku.

**Enver Memolla** . Një pyetje për drejtorin e financës e kemi këtu.

**Adriatik Lekaj** . Është investim i madh dhe i padobishëm.

**Indrit Dedej** . Zoti administrator, kishin dhënë 3 milion e gjys euro... ku janë pemët? Duhet t'i kishin mbjellë pemët para vjetësh, s'kishin lëvizur rruga. Ku janë pemët? Kanë marrë lekët. Firma e parë ka marrë 3 milion euro. Po, jam dakord.

**Erind Tosku** . Bashkia do flasë apo...?

**Qytetari** . Edhe ju që keni shkollë, spo merni vesh.

**Erind Tosku** . Kujdes me radhë.

**Mitat Daja** . Duhet të kemi parasysh banorët, sepse unë problemin e kam më shumë me banorët, ata e kanë hallin. Ne të tjerët jemi vetëm duke diskutuar këtu, dashamirës që kjo punë të zgjidhet. Por nuk jam dakord me administratorin që thotë "o 2 milion euro, o s'ka". Sot është emergjencë dhe ne si këshill bashkiak duhet të japim zgjidhje emergjence. Pastaj, administratori... ne nuk mund t'i kërkojmë llogari administratorit pse s'ka investuar 2 milion euro atje. Po pra, kjo është e drejta e administratorit: më vonë sjell projektin e gatshëm dhe ne si këshill bashkiak jemi të disponueshëm, kur ka projekte për të miratuar diçka të mirë. Sot ne po flasim për emergjencë dhe duhet t'ia lëmë radhën: emergjencat civile, administratori i zonës, urbanistika. Më fal, unë nuk jam as teknik ndërtimi. Por sot unë do të kërkoj llogari, pse e ke lënë deri në atë situatë atë rrugë, që të degradojë në atë lloj pike? Ta them unë ty sot, duhet të japësh llogari pse ka shkuar dhe është degraduar, sepse e keni lënë rrugën mëshirë të fatit. Edhe Malësia po të njëjtin problem ka. Rrugët janë lënë mëshirë të fatit dhe po degradojnë, dhe nuk shkojnë dot as të marrin ullinj të, as të shkojnë për ndonjë gjë. Prandaj ju administratorët, sot, të paktën duhet të heshtni kur ndodh emergjenca. Duhet të gjeni mundësi që njerëzve t'u jepni zgjidhje. Jepni mundësi. Nuk po e vras, po kërkoj llogari.

**Qytetari** . Taksat... mos merni taksa... ujë, drita... 35 vjet ju dëgjuam Parti Demokratike, Parti Socialiste, "do ta rregullojmë"...

**Erind Tosku** . Po mirë. Po të dëgjojmë. Vazhdo, vazhdo. Ok, vazhdo atëherë kërkesën.

Në rregull.

**Qytetari** . Ujë jo, drita jo... Ku jam unë? Ku jetoj unë?



**Erind Tosku** . A ke ardhur? Për çfarë ke ardhur sot?

**Qytetari** . Kemi ardhur për rrugën e të dy krahëve.

**Qytetari** . Unë paguaj taksë për tokën, për ujë, për dritë, për të gjitha. Ku shkojnë taksat e mia?

**Erind Tosku** . A do flasim për rrugën tani apo jo?

**Astrit Mertiri** . Po them që ta dini dhe ju të jeni të qartë, një pjesë të shërbimeve i marrin nga Rrogozhina, dhe pjesën më të madhe (energjinë elektrike, ujin, rrugën) i marrin nga Kavaja. Po kështu është sistemi.

**Qytetari** . Unë nuk jam Serbi. Jam Shqipëri, jetoj në Shqipëri. Taksat mua s'më hyjnë në punë fare. Unë dua shërbimin.

**Erind Tosku** . Ore, uluni dhe ju dëgjojmë më mirë.

**Qytetari** . Një nga një po flasim. Sot jam i bllokuar jam i bllokuar te rruga që e keni bërë asfalt. Kokat e arës mi e ke bërë asfalt, por unë nuk bëj dot deri te ajo arë sot, sepse jam i bllokuar nga një prua, jam i bllokuar nga çdo gjë. Nuk ka rrugë, asgjë atje.

**Erind Tosku** . Nuk po jemi kundër, nuk po jemi kundër që po i shtoni gjërat. Tani na lër të flasim edhe ne. Po ju s'na lini të flasim ne. Se ne do flasim me drejtorët përkatës se si të vijë ndihma.

Ju s'po na lini të flasim.

**Qytetari** . Po keni shkelur, nuk e di sa herë e keni shkelur atë rrugë. Edhe unë pse të flas? Po ta marr, po të ma kuptosh njëherë ke edhe ironi brenda. Dua drejtorin e financave, dua drejtorin e urbanistikës, dua drejtorët. Lëvizja jonë është kjo janë rrugë në të dy krahët. Doma është e bllokuar sot, këtu është. E dini këtë. Është emergjencë e madhe. Të gjitha keni qenë me gazetari, me parti, keni qenë të gjithë, por akoma sot na u ka prishur edhe rruga e arës, rruga që marrim për Spille. Atëherë, në qoftë se ju, zotëria, do ta zgjidhni, dakord.

**Erind Tosku** . Po të flas na dëgjoni. Tani, a kërkoni zgjidhjen nga ne? A kërkoni nga drejtori që t'i thërrasin drejtorët? Ke shërbimin e emergjencave, ke administratorin aty. Tani, nëse ne s'i pyesim këto se si do zgjidhim, si do bëjmë?

**Astrit Mertiri** . Kryetar, them edhe ç'ka bërë edhe para një muaji. Edhe sot kam marrë në atë telefon kryetarin e bashkisë së Kavajës dhe i kam thënë, bashkë me kryetarin në detyrë të Rrogozhinës, të shkojnë te Fondi i Zhvillimit ju nuk e imagjinoni përveç tyre që e kanë shkelur atje, nuk bëhet as me 200 milionë, as me 300 milionë lekë atje. Duhet më shumë. Unë thashë dy... mund të duhen tre milionë euro. Sepse atje duhet të bëhet një urë, një urë, një urë, që duhet të bëhet me pilota, të paktën 50–60 metra. Është kështu. Ju jeni gjyqtar apo jo? Nuk bëhet ndryshe, sepse nuk ka. Është e vetmja zgjidhje.



**Silvana Aliu** . Me këtë ke biseduar?

**Astrit Mertiri** . Kam edhe me Fisnikun, kemi folur dhe kemi rënë dakord që brenda 10 ditëve, siç thashë unë, të dy kryetarët, kryetari i tyre dhe Fisniku bashkë me prefektin dhe nënprefektin të shkojnë te Fondi i Zhvillimit, të vijojnë inxhinierët, të bëjnë një projekt dhe të bëhet rruga. Kjo gjë është... Urdhëro.

**Astrit Mertiri** . Është afatgjatë.

**Hekuran Xhani** . Po këto janë emergjencë. Si mund ta zgjidhim çështjen e emergjencës?

**Astrit Mertiri** . Më fal, më fal, emergjencë ajo ka 100 vjet, nuk ka... Pra është kot.Do t'i harxhoni, do t'i çoni 200 milionë lekë për ta...

**Erind Tosku** . Për të shmangur rrezikshmërinë, kemi ndërhyrje që mund të pyesim.

**Indrit Dedej** . Ne s'kemi mundësi për 3 milionë.

**Qytetari** . Duke filluar nga ti që je në karrigen e parë... 100 lekë nuk e bëjnë dot.

**Silvana Aliu** . Cfarë kërkoni te këshilli bashkiak sepse zotëria thotë që aq sa kërkon, nuk e kemi ne.

**Qytetari** . Edhe ti ke qenë, edhe ti edhe ai. Edhe unë po e them: lekët... nuk di... Atëherë nuk jemi të ndërgjegjshëm ne që po themi: e kalueshme është e vështirë. Ne, veç kësaj, themi jemi bllokuar sot.

**Qytetarja** . Po mendoj që ajo rruga tjetër që thotë "zotëria" që zbret poshtë tek arat... ndoshta është zgjidhje. Por edhe ajo është rrugë e prishur dhe kërkon më shumë punë për t'u rregulluar, sepse nuk mund të zbresësh poshtë me makinë. Për momentin ajo është rrugë jo funksionale për të kaluar. Ajo rrugë është një rrugë alternative që ndoshta mund të bëhet shpejt, por nuk është rrugë për gjatë. Në një moment të caktuar ajo ura ka për të rënë; dikush ka për të rënë. Falni, a mund të flas pak? Se kam diçka që po e mbaj dhe kam vërtet nevojë të them diçka. Po thoja që duke qenë se ajo rrugë, pra pjesa e rripit, gërryhet dhe hollohet gjithnjë e më shumë nga shirat, nga ujërat, nga makinat, nga betonierët, nga çdo gjë që kalon aty, në një moment të caktuar dikush ka për të rënë. Kjo është e sigurt. Unë sa herë që kaloj aty, u them të gjithë familjarëve zbrisni në këmbë dhe pastaj kaloj unë. Mendohej të ec me frikë, duke iu lutur zotit a po bie apo nuk po bie? Tani, duke qenë se po thoni për rrugë alternative gjë që unë mund të them si banuese e këtij fshati, është ajo rruga që zbret nga fshati në anën tjetër.



Por edhe ajo rrugë, për momentin, gjithashtu është e shkatërruar e kanë shkatërruar shirat, ujërat, makinat, gjithçka. Kështu që ndoshta mund të jetë një alternativë e përkohshme, për momentin, që na mundëson neve të zbrisim nga Dome në Spille dhe pastaj të kapim veshin kështu për të rënë në Kavajë, të paktën edhe për tokat. Por është edhe kjo gjëja që ngriti zotëria shqetësimi që në momentin kur ti zbret nga kodra për të zbritur tek fushat, aty normalisht nuk ka rrugë për të zbritur te rruga me asfalt. Aty normalisht janë toka të njerëzve, të fshatarëve. Nuk e di dikush e hapi njëherë një rrugë, një tjetër e mbylli. Domethënë është një lloj kaosi shumë i madh edhe aty. Kështu që kjo rrugë, edhe pse mund të jetë rrugë alternative, do hasë probleme me një person që është zotëruar i kësaj toke, ose nuk e di se si mund të zgjidhet një rrugë tjetër. Nuk e kam ide. Vetëm kjo ekziston për momentin. Kaq. Kurse ura pastaj është...

**Silvana Aliu** . U deshëm tre vjet nga zgjedhjet me i kërkuar llogari zotërisë për rrugën, se patëm mundësi këtu tre vjet...

**Qytetarja** . Unë për vete kam pesë vjet që jetoj aty dhe nuk di të jetë ngritur ndonjëherë rruga në shtet. Kërkesa është bërë nga burri im, që ne kemi ardhur sot. Më fal pak, më fal pak... më falni, zotëri. Ky shqetësim nuk është... unë nuk di të jetë hedhur ndonjëherë nga askush ky shqetësim. Absolutisht jo. E vetmja herë që ka ndodhur është kësaj here dhe ka qenë me kërkesë për ta bërë këtë gjë. Unë nuk kam dëgjuar as nga administratori, as nga kryeplaku i fshatit, nga askush, të vijë e të na thotë hajde të mblidhemi dhe të shkojmë të bëjmë një kërkesë, jo vetëm për rrugën, por për dritat, për ujin, për të gjithë.

**Astrit Mertiri** . Ja po të them unë kishin punuar administratorët aq sa ka punuar ky për atë zonë, ju nuk e dini.

**Hekuran Xhani** . Problemi në fjalë është edhe imi, sepse ne jemi pjesë e hallit tuaj, jemi familjarë. Unë jam dhe fshatar. Problemi i 3-4 milionëve që thotë zotëria, po të garantoj që për dy vjet nuk e zgjidh dot.

**Qytetarja**. As për 15 vjet.

**Hekuran Xhani** . Dëgjo e quaj që po angazhohet shumë vetë me Fondi i Zhvillimit për rrugët kanë ngelur edhe me qeverinë, shumë rrugë kanë ngelur. Për tre vjet i bëjnë, në fund. Dhe problemi është ju jeni në emergjencë. Ju mos pretendoni ta zgjidhni emergjencën me 3 milion euro. Unë them që për dy vjet, edhe me procedura të përsheptuara, nuk do të arrini ta zgjidhni dot. Prandaj unë po ju drejtohem qartësisht ju kërkoni zgjidhje emergjente, apo do prisni dy vjet, tre vjet, ose ndoshta edhe 35 vjet, sa kanë kaluar? Nuk dua të mbështes zotërinë, por...

**Hekuran Xhani** . Po të drejtohem ty tani, sepse je në krah të saj, dhe ajo e foli shumë qartë dhe shumë saktë. Unë e di problemin që është atje dhe ky problem nuk është sot. Ky problem është



pesë... Po, siç vazhdon politika shqiptare, mund të shkojë edhe shtatë vjet dhe mos të gjeni zgjidhje. Problemi qëndron në si këshill bashkiak kemi kompetencë për fondin e zhvillimit mund ta miratojmë si projekt dhe të jemi dakord që të shkojë. Por ne nuk mund të ndërhyjmë para shtetit shqiptar. Kompetenca jonë është deri këtu. Për zgjidhjen emergjente, meqë drejtori i financës është këtu, të shikojmë te buxheti i bashkisë a mund t'ju zgjidhim çështjen e emergjencës, nëse kërkon këtu. Drejtorja të sjellë një kërkesë, administratori... nëse duhet të rregullohet me ndërhyrje për një vit... Unë do vij, punoj punëtor gjatë gjithë sezonit, vullnetar...

**Enver Memolla** . Pyetja është rruga e vjetër ekziston në hartë?

**Qytetari** . Një sekondë, atëherë këto janë rrugët... Unë jam i lindur... jam 60 e ca vjeç. Kjo ka qenë... pastaj unë kam ardhur... është banues... Nuk e dimë këtë tokën si është ndarë. Se e kam ndarë unë tokën. Prandaj i kërkoj ajo është rrugë që neve na ka prishur. Ne i kemi dhënë emra. Ju i thoni "Rrepara", por ne i themi Gërrona e keqe ne i themi Përroi i keq prandaj ka dhe emrin "i keq", sepse është i keq s'na lë me u futur në arë.

**Indrit Dedej**. Po mirë, po ka rrugë nga arat të bësh një urë?

**Qytetari** . Ne po kërkojmë... në qoftë se nuk... Unë e thashë që ne po kërkojmë një rrugë kalimi. Në qoftë se s'më keni dëgjuar, ne duam rrugë kalimi.

**Hekuran Xhani** . Ti e di terrenin, e njeh terrenin, po ti dëgjo hajde këtu.

**Qytetari** . Atëherë, zgjidhje na thoni ose çoni kërkesën. E tha shumë mirë edhe ai që ishte këtu bëni edhe skarifikimin ku do ti. Nëse bëhet vetëm me hapje dy... bëni tre metra. Nuk po ta kërkoj tani edhe njëherë. Unë e dua, mundësisht, asfalt dy kalime atje

**Erind Tosku** . E shpejtë është zgjidhje, sa të prisni që të bëhet rruga. Po kërkojmë dhe po diskutojmë këto.

**Shpati Kolgega** . Tani, propozim... a bëj propozim? Problemin e kuptuam, besoj, të gjithë. Pra, jeni të qartë kush është problemi e kuptuam që është emergjencë, pra që ka një emergjencë, sepse mund të vijë nesër dita dhe të mos shohim dot ndonjë gjë, ose s'do kalojnë dot, ose emergjenca duhet të thotë që aty nuk duhet të kaloni më. Më mirë thoni mos kaloni më, rrini në shtëpi, sesa të kalojnë dhe, larg qoftë, të ndodhë ndonjë gjë. Kjo përgjegjësi duhet marrë. Në fakt, kjo përgjegjësi duhet të merret nga një ekspert, ose duhet të merrni një ekspertizë nga Drejtorja e Rrugëve. dhe i thoni hajde të na thonë kalohet apo s'kalohet. Po ju thoni s'kalohet, mbylleni rrugën se, larg qoftë, do ndodhë ndonjë gjë. Jo, jo. Po prit pra, prit. Më mirë ta mbyll, se ajo që propozoj... më fal... Nuk kemi ku shikojmë ne jemi Këshilli Bashkiak, nuk jemi ekzekutivi i bashkisë. Bashkia ka fond për rrugët për vitin 2026 dhe, në qoftë se ka një fond për rrugët, a mund bashkia të bëjë një...? Jo, ta mbaroj dhe pastaj më thuaj. Unë propozoj që, me emergjencë,



urbanistika e bashkisë, inxhinierët nga bashkia, mirëmbajtja, të shkojnë në terren dhe të vijnë në bashki apo në këshill me një propozim emergjent që ne të propozojmë të rregullojmë rrugën që tha zonja tha duhen 100–200 milionë lekë, le ta rregullojmë atë rrugë që të jetë e kalueshme. Dua që bashkia të shkojë në terren dhe të vijë me një propozim këtu, se ne mund të themi ai mund të kërkojë tunel, unë kërkoj urë... Aty duhet të shkojnë ekspertët tanë. Të propozohet kjo si zgjidhje emergjente dhe të vijnë ata ta propozojnë, sepse ne jemi jokompetentë për të propozuar zgjidhje, dhe administratori, besoj, është jokompetent nga ana inxhinierike apo e projektimit. Atje do të shkojnë specialistët e bashkisë me mundësitë dhe ekspertizat që kanë dhe të vijnë të propozojnë këtë zgjidhje me këtë buxhet, dhe ne jemi gati të miratojmë çdo lloj buxheti që propozohet, me mundësitë e bashkisë, që të ketë zgjidhje emergjente. Pra, këtë mendojmë që duhet të propozojmë ne si zgjidhje sot që flasim dhe, në mbledhjen tjetër, apo në një mbledhje jashtë radhe, hajde ta miratojmë ndryshimin e buxhetit dhe të fillojë të bëhet atje një riparim, një ndërhyrje emergjente. Për projektet e mëdha pastaj është e kryetarit të bashkisë, apo e kryetarit të bashkisë Kavajë, që të shkojmë të propozojmë një projekt siç duhet dhe të bëhet kur të miratohet. Po duhet ta zgjidhim me fondet tona dhe me mundësitë e bashkisë sot që flasim, që mos të shkojë deri aty.

**Rezart Vogli** . Drejtoria e financës është e gatshme të mbështesë çdo iniciativë të re buxhetore. Por, pikë së pari, ne duhet të vlerësojmë koston e këtij projekti. Pa vlerësuar koston e projektit, ne nuk kemi dot asgjë sot ,të përcaktojmë burimin e financimit nga bashkia, nga granti dhe pastaj nëse është e nevojshme, edhe ndryshime buxhetore ashtu siç e parashtrova. Pikë së pari duhet të dimë çfarë kosto ka. Duhet të punojë drejtoria momentalisht...

**Erind Tosku** . Sa zgjidhje alternative ka fshati, të shpejta dhe efektive?

**Astrit Mertiri** . E vetmja, për t'u lidhur me Stërbegu, me Rrogzhinën, me Kavajën, është... zero. E vetmja është ajo alternativë nuk ka tjetër. Besoj ju që keni qenë për fushatë e keni parë është e vetmja. Kështu që nuk ka tjetër.

**Erind Tosku** . Po ajo që tha zoti Adriatik...

**Astrit Mertiri** . Kush?

**Erind Tosku** . Nga Stërbegu.

**Astrit Mertiri** . Pra do kalosh aty.

**Qytetarja** . Këtu kalojmë momentalisht. Ajo që tha, të zbritet... që është zgjidhje alternative për momentin.

**Astrit Mertiri** . Ky mendimi im vetëm kjo zgjidhje. Por ajo "zero" ka vetëm një zgjidhje që të ulet pra duke u ulur niveli. Ajo është 2.6 tani po ta ulim 3 metra ose 4 metra...



**Qytetari** . Është zall.

**Astrit Mertiri** . Po të ulet, bëhet, po të ulet ajo metrat do zgjerohet, do bëhet 6 metra gjerë si rrugë.

**Enver Memolla** . A mundet të merrni një inxhinier që ta studiojë?

**Erind Tosku** . Atëherë për rrugë alternative, cili alternativë është kjo tjetër?

**Qytetarja** . Zgjidhje alternative është kjo nga Spilleja.

**Erind Tosku** . Patjetër, patjetër.

**Qytetare** . Ajo rrugë që jo vetëm skarifikim të bëhet, por të bëhet e kalueshme.

**Erind Tosku** . Duke bërë atë që tha zoti Shpati .

**Adriatik Lekaj** . Unë e propozova zgjidhje emergjente, thatë jo . Kjo quhet emergjencë që bëhet me pak lekë.

**Alime Hoxha** . Një sekondë tani, se ju keni dëgjuar. Në përfundim, t'i marrim pak rastet i kemi dëgjuar të gjitha dhe më shumë po bërtasim, po bëjmë zhurmë, sesa po japim zgjidhje . Tani ju thoni që ajo rruga nga Kavaja është e pamundur të rregullohet. A keni mundësi që të shkojmë nga Spilleja ? Pra të rregullohet? Këtë po themi, po.

**Qytetarja** . Po shumë mirë.

**Alime Hoxha** . Pra tani, a keni mundësi?

**Qytetarja** . Për momentin nuk ka, duhet rregulluar.

**Alime Hoxha** . Tani këtu jemi me bashkinë, Rezi dhe inxhinieri i urbanistikës që është... a kemi mundësi të sistemojmë atë rrugën?

Kjo është zgjidhja të bëhet një projekt për buxhetinnjë mbledhje emergjentet, që ta mbyllim këtë muhabet, sepse po e zgjasim kot.

**Mitat Daja** . Unë mendoj që, nëse është e lejueshme dhe e mundshme, ne sot marrim vendim t'i kërkojmë bashkisë që të bëjë një projekt ose rregullimin e rrugës nga Domja, por në Spille , ajo rruga që është rrugë alternative. T'ia kërkojmë ne bashkisë me vendim të Këshillit Bashkiak, me qëllim që këto mos e lënë pas dore këtë punë.

**Erind Tosku** . Po.

**Mitat Daja** . Kjo është ideja, kjo është ajo që them unë tani ta vendosim. Biem dakord për këtë dhe u zgjidh problemi. Pastaj, për investime afatgjata, administratori do kërkojë, se këtë punë ka.



**Enver Memolla .** Fondin e emergjencës civile e kalojmë për urgjencën që ka fshati Domën me rrugën, dhe të kryhet sa më shpejt.

**Erind Tosku .** Atëherë të nderuar këshilltarë hedhim në votim që fondin e emergjencës emergjenca civile të kalojë për rrugën e Domës dhe të kryejë punime sa më shpejt. Hedhim në votim?

*Po, të gjithë miratohet*

Pra, miratohet që emergjencat civile të kalojnë për rregullimin dhe zgjidhjen, që të jetë e zgjidhshme, sipas asaj që u diskutua.

**Alime Hoxha .** Jo, ta bëjnë sa më parë. Mbledhje emergjence kalon.

**Erind Tosku .** E miratuam sot, zotëri.

**Adriatik Lekaj .** Atëherë fondi i emergjencës civile përdoret vetëm me vendimin e këshillit.

Duhet bërë projekti, shuma sa është fondi... Ne mblidhemi urgjent, dakord, që të bëhet projekti.

**Erind Tosku .**Ne mblidhemi jashtë radhe në momentin që do kalojnë direkt ato...

**Silvana Aliu.** Ore, bashkia...

**Qytetari .** Faleminderit shumë, faleminderit. Jepni fjalën, se mos na bëni kështu, një krah, një krah.

**Qytetarja .** S'di si mund ta ndjekim këtë situatë konkretisht, po unë do doja të kisha një mënyrë, nuk e di se si, që ta ndjek këtë gjë hap pas hapi dhe jo të rri, të fle gjumë, dhe pastaj pas tre vjetësh të vijmë prapë e themi "kjo është emergjencë".

**Erind Tosku .** Këshilli Bashkiak... deklaroj të mbyllur.

Faleminderit. Faleminderit shumë të gjithëve.



**REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
BASHKIA RROGOZHINË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**MBYLLET MBLEDHJA**

- Mbledhja deklarohet e mbyllur zyrtarisht rreth orës 15 : 20<sup>00</sup> . Video regjistrimi i kësaj mbledhjeje zgjati 01 orë 16 min ; 11 sek.
- Ky procesverbal i përmbledhur mbyllet në faqen 23 ( njëzet e tre).

**Zbardhi (transkriptoi) procesverbalin :**  
**Sekretari i Këshillit**  
**Ervis Shera**